



Kryetari i Komunës

Nr: 02 /

Datë: 09.06.2016

Deçan

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nenit 11, paragrafi 1, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, neni 3 paragrafi 1 dhe 2 si dhe Vendimi Nr.02 i Kryetarit të Komunës shpall këtë:

K O N K U R S (shpall)

Institucioni:	Komuna e Deçanit
Drejtoria:	Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Strehimore (1 nëpunës)
Kategoria funksionale/Grada:	Koeficienti- 9
Numri i referencës:	RN00000990
Lloji i pozitës:	Karrierës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për disiplinën dhe mbarëvajtjen e punëve në Shtëpinë e Komunitetit ;
- Përpilon orarin dhe përcakton ndërrimet e punëtorëve gjatë javës;
- Kontrollon ardhjen dhe shkuarjen e punëtorëve nga puna;
- Në bashkëpunim me stafin aktual përcjell gjendjen shëndetësorë të klientëve;
- Në bashkëpunim me stafin e kuzhinës përcjell kualitetin e shujtave dhe përgatit kërkesat për furnizime mujore për ushqime;
- Bashkëpunon me institucionin baze Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në të mirë të Rezidentëve;
- Raporton tek Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për punën dhe aktivitetin e Shtëpisë Rezidenciale;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollë dhe aftësi fizike që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar.

Shkollimi i kërkuar: Diplome Universitare.

Aftësi / përvojë dhe atribut tjera që kërkohen: të paktën katër (4) vite përvojë pune; njohuri profesionale; të ketë aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: **Zyrës së Personelit Nr. 45**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data: **10-06-2016 deri 24-06-2016.**

Aplikacionit i bashkëngjitet kopja e dokumentacionit mbi kualifikimin, Ekstraktin e lindjes, përvojën e punës, certifikata të trajnimeve nëse ka, Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës, certifikata shëndetësore dhe dokumentacione tjera për këtë pozitë.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë për interviste njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor nga personeli, kandidatet janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.